Marrëveshja Shqipëri-Itali për sigurimet shoqërore

- Përmbledhje dhe procedurat e aplikimit



Marrëveshja dhe BE

- Marrëveshja është në përputhje me Rregulloren 883/2004 të Bashkimit Europian mbi koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore.
- Synimi i Marrëveshjes,është koordinimi i sistemeve të sigurimeve shoqërore, duke shmangur humbjen e të drejtave për shkak të lëvizjes midis dy vendeve.
- Kjo përputhshmëri siguron funksionim të ngjashëm dhe lehtëson integrimin e ardhshëm të Shqipërisë në strukturat eurpiane të sigurimeve shoqërore

Zbatimi i Marrëveshjes

- Aplikohet për personat që kanë punuar e paguar kontribute në Shqipëri, Itali ose të dy vendet.
- Përfshin anëtarët e familjes dhe pasjetuesit.
- Nuk ka kufizime për kombësinë apo vendbanimin.
- Hyri në fuqi më 1 korrik 2025

Fusha e zbatimit të Marrëveshjes

- **Sipas legjislacionit shqiptar:**
  - Pension pleqërie, invaliditeti, familjar
  - Përfitime për sëmundje, barrëlindje dhe papunësi
- **Sipas legjislacionit italian:**
  - Pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar (të pasjetuesve) për të punësuarit, duke përfshirë skemat e veçanta të të vetëpunësuarëve (artizanë, tregtarë, fermerë)
  - Përfitime për papunësi
  - Përfitime për sëmundje, përfshirë tuberkulozin, dhe barrëlindje

Institucionet Kompetente

- **Në Shqipëri**: Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)

- **Në Itali:** Istituto Nazionale della Previdenza Sociale (INPS)

Parimet Kryesore të Marrëveshjes

- **Trajtim i barabartë:** Të gjithë trajtohen në mënyrë të barabartë me shtetasit vendas.
- **Zbatimi i ligjislacionit të vendit të punës:** Si rregull, aplikohet ligji shtetit ku ushtrohet punësimi me disa përjashtime (punonjës të dërguar përkohësisht, deri ne 24 muaj, ose të vetëpunësuar per nje periudhe të kufizuar kohe) të cilët vazhdojnë te sigurohen në vendin e origjinës
- **Eksportueshmëri të përfitimeve**: Pensionet dhe përfitimet në para mund të paguhen kudo, panvarësisht vendbanimit.
- **Totalizim periudhash:** Periudhat e sigurimit të mbledhura në të dy vendet bashkohen për të arritur kushtet minimale të nevojshme për të fituar të drejtat nga skemat përkatëse të sigurimeve shoqërore.

Llogaritja e Pensionit

- Pensioni llogaritet sipas legjislacionit të secilit shtet.
- Kur periudhat nuk mjaftojnë në një shtet, mund të bëhet pension proporcional.
- Periudhat më pak se 1 vit bashkohen me periudhat e shtetit tjetër..
- **Profesionet e veçanta dhe bashkimi i periudhave**:
  - Nëse një profesion ka skemë të veçantë sigurimi (p.sh. minator nëntoke), bashkohen periudhat e punës në atë profesion.
  - Nëse në shtetin tjetër nuk ka skemë të tillë, periudhat e punës në të njëjtin profesion ose në një punë të ngjashme sërish merren parasysh.

Përfitimet e Tjera


- Sëmundje & Barrëlindje – njohje reciproke e certifikatave.
- Përfitimet për sëmundje barrelindje paguhen nga institucioni kompetent i shtetit ku është realizuar veprimtaria e fundit e punësimit.
- Papunësia – mund të bashkohen periudhat e sigurimit për përfitim.
- Ruajtja e pagesës së papunësisë për 3 muaj nëse personi shkon në shtetin tjetër për punë.

Bashkëpunimi Administrativ

- Administratat e ISSH dhe INPS bashkëpunojnë drejtpërdrejt; për të aplikuar mjafton t'i drejtohesh zyrës së sigurimeve shoqërore të vendbanimit sipas procedurave administrative të sejcilit shtet.
- Residentët në Itali nuk duhet të kërkojnë individualisht verifikime periudhash sigurimi pranë ISSH-së; mjafton të plotësojnë "*Deklaratën e historikut të punësimit në Shqipëri*". ISSH verifikon dhe dërgon konfirmimin INPS-it.
- Dokumentat dhe kërkesat janë të përjashtuara nga tarifa, viza legalizime diplomatike /konsullore.


ACCORDO TRA
LA REPUBBLICA DI ALBANIA E LA REPUBBLICA ITALIANA IN MATERIA DI SICUREZZA SOCIALE
MARRËVESHJE MIDIS
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ITALIANE NË FUSHËN E SIGURIMEVE SHOQËRORE

DICHIARAZIONE DELLO STORICO LAVORATIVO
DEKLARATA E HISTORIKUT TË PUNËSIMIT


Periodi di lavoro in Albania
Periudhat e punësimit në Shqipëri

Da (GIORNO/Ditë (DIN/V)
A (GIORNO/ Dari me (DIN/V)
Professione/ Profesioni
Datore di lavoro/ Azienda - Località: Distretto, Città
Subjekti punëdhënës /Ndërmarrja – Vendi: Rrethi,Qyteti

Firma del richiedente / Nënshkrimi i kërkuesit
Data / Data
Firma / Nënshkrimi

Kërkesa për pension

- Kërkuesi paraqitet pranë institucionit kompetent te vendbanimit(ose të njërës palë në rast se banon në një vend të tretë)
- Institucioni plotëson formularin përkatës sipas llojit të përfitimit të kërkuar dhe dërgon informacionin tek pala tjetër.
- Verifikohet e drejta sipas legjislacionit të vendit dhe nëse është e nevojshme, bashkohen periudhat nga të dy vendet.
- Vendimi dhe periudhat e sigurimit komunikohen dhe përfitimet jepen drejtëpërdrejt nga institucioni kompetent
- Shkëmbimi I formularëvedhe informacionit bëhet **elektronikisht,** duke lejuar palët të menaxhojnë praktikat më shpejt dhe të shmangin postën fizike

Procedura për pension sipas marrëveshjes

Aplikuesi **me banim në Itali** paraqet kërkesën në INPS

INPS përcjell kërkesën ISSH-së (DIZMJ), nëpërmjet formularëve IT/AL 2,3 ose 4, së bashku me periudhat italiane të sigurimit IT/AL205

ISSH (DIZMJ) përcjell formularët e ardhur nga INPS në DRSSH/DSSH

DRSSH/DSSH shqyrton kërkesën dhe percakton përfitimin me apo pa bashkim periudhash,

Vendimi përfundimtar si dhe periudhat e konfirmuara i përcillet ISSH-së(DIZMJ)

ISSH i komunikon vendimin INPS-it dhe aplikuesit nëpërmjet AL/IT 5

Aplikanti **me banim në Shqipëri** aplikon sipas procedures në DRSSH/DSSH

DRSSH/DSSH shqyrton kërkesën dhe verifikon periudhat

DRSSH/DSSH i kërkon ISSH-së (DIZMJ) periudhat italiane të sigurimit, nese nuk plotesohen kushtet minimale për caktimin e pensionit

ISSH (DIZMJ) koordinohet me INPS dhe i përcjell DRSSH/DSSH periudhat italiane IT/AL205

DRSSH/DSSH njofton aplikuesin dhe ISSH (DIZMJ), e cila i komunikon vendimin INPS-it nëpërmjet formularit AL/IT 5

Për më shumë informacion

- **Faqet zyrtare të dy institucioneve:**
  - https://www.issh.gov.al/wp-content/uploads/2025/06/Udhezues-mbi-Marreveshjen-dypaleshe-mes-Shqiperise-dhe-Italise.pdf
  - https://www.inps.it/it/it/inps-comunica/atti/circolari-messaggi-e-normativa/dettaglio.circolari-e-messaggi.2025.07.circolare-numero-106-del-01-07-2025_14969.html

- **Patronatet**

  Patronatet që kanë protokolle bashkëpunimi me ISSH-në asistojnë qytetarët edhe në Shqipëri, -përmes zyrave të tyre në territorin shqiptar.

Faleminderit për vëmendjen !